

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Studimi zbulon moshën kur plakja përshpejtohet, ndryshimet më të mëdha ndodhin rreth kësaj moshe – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/studimi-zbulon-moshen-kur-plakja-pershpejtohet-ndryshimet-me-t-e-medha-ndodhin-rreth-kesaj-moshe/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 17:49:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	2 shtator 2026, 13:52:04 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5419cfec7b0de3222b8204c7a35779a7e9d8114a6ed0af29ba9e71c37003d263
TEKSTI	5ca923cc30962626b24244aafed916b34eb59d6800f896df4db97f70a9945ce2
PAMJA	ec0788ee8ba3529f80125e0b8ec1e7352cc55bdf45f2ea202927c3a9a1b999

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7d140f8c6afdbf48a8224d9eb1bee97d9e1a7304c6f37e6101ca822a58497ea4
E MËPARSHMJA	c5c046d64994e86d1b6689c9ed475bd696fe2249572fe2ce759c1c5cab731a7a
RRËNJJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7d140f8c6afdbf48a8224d9eb1bee97d9e1a7304c6f37e6101ca822a58497ea4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Plakja e trupit nuk ndodh në mënyrë të njëtrajtshme gjatë gjithë jetës. Një studim i ri i referuar nga ScienceAlert sugjeron se organizmi kalon nëpër faza të ndryshme dhe se një përshejtim i rëndësishëm i plakjes biologjike mund të ndodhë rreth moshës 50-vjeçare. Studiuesit kanë vërejtur ndryshime të dukshme në qeliza, inde dhe organe, me enët e gjakut që rezultojnë ndër strukturat më të prekshme.

Kërkimi, i kryer nga një ekip i Akademisë Kineze të Shkencave, u bazua në analiza të mostrave të indeve nga 76 dhurues organesh, të moshës 14 deri në 68 vjeç. Shkencëtarët analizuan shtatë sisteme të trupit dhe zhvilluan të ashtuquajturat "orë proteomike", të cilat përdorin ndryshimet në proteinat e organizmit për të vlerësuar moshën biologjike të indeve.

Sipas rezultateve, periudha mes moshës 45 dhe 55 vjeç duket të jetë veçanërisht e rëndësishme, pasi në këtë fazë u vunë re ndryshime të mëdha në nivelin e proteinave. Aorta rezultoi ndër indet që shfaqën më herët dhe më qartë shenjat e plakjes, ndërsa pankreasi dhe shpretka treguan gjithashtu ndryshime të konsiderueshme. Analizat lidhën 48 proteina të ndryshme me sëmundje që bëhen më të zakonshme me kalimin e moshës, përfshirë problemet kardiovaskulare, sëmundjet e mëlçisë dhe disa lloje tumoresh.

Studiuesit testuan më tej një prej proteinave të identifikuara në eksperimente me minj. Kafshët e reja që morën proteinën e marrë nga aorta e minjve të moshuar shfaqën dobësim të forcës së kapjes, qëndrueshmërisë, ekuilibrit dhe koordinimit, si dhe shenja të plakjes së

5 "Dhembja e pjezurisë mund të shkaktojë tumor", kirurgu oral: Kur...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

enëve të gjakut. Shkencëtarët theksojnë se këto rezultate mund të ndihmojnë në kuptimin më të mirë të mekanizmave të plakjes dhe, në të ardhmen, në zhvillimin e trajtimeve më të personalizuara për sëmundjet që lidhen me moshën.

#Plakje



Ana Miha

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh




LIFESTYLE

Kush janë shenjat më besnike dhe më...

Xhuljana
Zhuleku

Dje
21:32



LIFESTYLE

"Një surprizë mund t'ju ndryshojë..."

Xhuljana
Zhuleku

Dje
10:32



LIFESTYLE

Pse gërhitja e partnerit mund të...

Taulant Halili · 12 Sht



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë

Bota

Vendi

Kronikë

Lifestyle

Programe

Programe

Seriale

Guida TV

Video

Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh

Karriera

Kontakt

Reklamo me ne

Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit

Privatësia

Cookies

Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.